



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK**

PROJEKTVENDIM

NR____, DATË__/_/_/ 2026

**PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET PËRFITUESE QË
PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “RESTAURIMI DHE RIKUALIFIKIMI URBAN
I ZONËS PERSPEKTIVE TID, ME VENDNDODHJE NË PARKUN
ARKEOLOGJIK Durrës”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar”, ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 301, datë 15.4.2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për Banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me Kosto të ulët”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 814, datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 1.3.2023 Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID, me vendndodhje në Parkun Arkeologjik Durrës”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 477, datë 31.7.2025 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID, me vendndodhje në Parkun Arkeologjik Durrës, me zhvillues Bashkia Durrës”, me vlerë 315,524,013.82 lekë”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.73 datë 23.12.2025 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.110, dastë 16.12.2024 “Për miratimin e vlerës së shpronësimit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken apo zhvlerësohen nga realizimi i projektit të rjetëzimit të zonës arkeologjike “TID” Durrës, për zhvillimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.32, dastë 23.06.2025 “Për miratimin për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 110, datë 16.12.2024, “Për miratimin e vlerës së

shpronësimit për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken apo zhvlerësohen nga realizimi i projektit të rijetëzimit të zonës arkeologjike “TID” Durrës, për zhvillimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 41, datë 21.05.2024 “Për miratimin e vlerës mesatare të qirasë së apartamenteve të banimit për efekt të subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”, sipas relacionit përgatitur nga Drejtoria Ligjore dhe Drejtoria e Shërbimeve Sociale, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e subvencionimit të qirasë për familjet përfituese që preken nga zbatimi i projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID, me vendndodhje në parkun arkeologjik Durrës”.
2. Subvencionimi i qirasë miratohet deri në afatin e likuidimit të vlerës financiare të shpronësimit, por jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj, referuar kritereve ligjore parashikuar në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
3. Ky fond do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Durrës i vitit 2026.
4. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike pranë Bashkinë Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtör
Alneida Rroshi

DREJTORIA SHËRBIMEVE SOCIALE

Drejtör
Diola Xhango

DREJTORIA EKONOMIKE

Drejtör
Ina Ferra

DREJTORIA E BUXHETIT

Drejtör
Valbona Qiriako

KRYETAR I BASHKISË

Emiriana Sako